



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1585/1 Prot.

Tiranë, më 17. 12. 2025

V E N D I M

Nr. 301, datë 17. 12. 2025

Bazuar në ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O N :

Duke marrë indicien nga transmetimi² në median lokale “Star Plus Tv”, të datës 26.03.2025, me tematikë: “*Hyrja e Shkodrës, romët kundër lirimit të banesave*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në nenin 41/2/a³ të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, si dhe në nenin 32, pika 1, shkronjat c), f) dhe pika 2, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, me Urdhrin Nr. 40, datë 27.03.2025, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes së largimit të banorëve të pakicës rome në Shkodër nga vendbanimet e tyre, si pasojë e zbatimit të projektit të rikualifikimit të hyrjes së qytetit. Me të njëjtin objekt ankese, pranë Komisionerit është paraqitur dhe ankesa Nr. 98, datë 22.04.2025, e shtetasve: E. H., M. G., N. G., Sh. D., I. H., E. R., I. H. dhe A. H., që i përkasin pakicës rome.

Sa më sipër, duke qenë se ankesa Nr. 98, datë 22.04.2025 dhe çështja e nisur kryesisht me Urdhrin Nr. 40, datë 27.03.2025, janë drejtuar kundër të njëjtit subjekt (Bashkisë Shkodër) dhe kanë të njëjtin objekt (largimin nga vendbanimet e tyre, si pasojë e zbatimit të projektit të rikualifikimit të hyrjes së qytetit të Shkodrës), mbështetur në nenin 33, pika 7/3⁴, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri me vendimin Nr. 94, datë 28.04.2025, vendosi bashkimin e trajtimit të

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën Komisioneri.

² https://www.youtube.com/watch?v=Q1iLJ9_OsHo

³ Neni 41/2/a i Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, parashikon se: “Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës...”.

⁴ Neni 33, pika 7/3, i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon “Në rastet kur ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, drejtuar të njëjtit subjekt, kanë të njëjtin objekt, mund të bashkohen në një ankesë të vetme.”

këtyre çështjeve. Me vendimin Nr. 161, datë 07.07.2025, Komisioneri ka disponuar në lidhje me çështjen, duke vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “diskriminimit strukturor” të ankuesve⁵ dhe familjeve të shpërngulura nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”, në të drejtën për strehim të përshtatshëm, për shkak të “racës/etnisë” nga ana Bashkisë Shkodër.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Shkodër duhet të marrë masa për:
 - sigurimin në mënyrë emergjente të një strehimi të përshtatshëm, për ankuesit dhe familjet e shpërngulura të pakicës rome nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”;
 - sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, për ankuesit dhe familjet e shpërngulura të pakicës rome nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”.
3. Bashkia Shkodër duhet të dërgojë një plan veprimi për sistemimin e ankuesve dhe familjeve të shpërngulura nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”, ku të evidentohen masat e nevojshme, që ky institucion ka planifikuar për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, përgjatë 6 (gjashtë) muajve të ardhshëm.
4. Bashkia Shkodër duhet të raportojë çdo 2 (dy) muaj pranë Komisionerit mbi mënyrën se si janë zbatuar masat e planit të veprimit për sistemimin me strehim të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë të ankuesve dhe familjeve të shpërngulura nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës.
5. Mbështetur në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Shkodër, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa.....”

⁵ E. H., M. G., N. G., Sh. D., I. H., E. R., I. H. dhe A. H.

Me shkresën⁶ nr. 13807/1 prot., datë 18.08.2025, Bashkia Shkodër ka informuar Komisionerin në lidhje me zbatimin vendimit Nr. 161, datë 07.07.2025, ndër të tjera se: *“Referuar masave të parashikuara në vendimin e KMD-së, në planin e veprimit që Bashkia Shkodër do të zbatojë, do të shikohet mundësia e përfitimit nga programet e strehimit social të familjeve ankuese të prekura nga projekti, sipas legjislacionit në fuqi dhe kriterëve të përcaktuara, duke marrë në konsideratë situatën aktuale të tyre, procesin e regjistrimit në gjendjen civile dhe vlerësimin social-ekonomik individual të çdo familjeje.”*

Me shkresën nr. 660/9 prot., datë 10.11.2025, Komisioneri iu drejtua sërish Bashkisë Shkodër duke kërkuar informacion sa i përket hapave konkret të ndërmarrë lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 161, datë 07.07.2025, sa i përket:

- *sigurimit në mënyrë emergjente të një strehimi të përshtatshëm, për ankuesit dhe familjet e shpërngulura të pakicës rome nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”;*
- *sigurimit të një strehimi të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, për ankuesit dhe familjet e shpërngulura të pakicës rome nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”.*
- *hartimit të një plan veprimi për sistemimin e ankuesve dhe familjeve të shpërngulura nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”, ku të evidentohen masat e nevojshme, që ky institucion ka planifikuar për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, përgjatë 6 (gjashtë) muajve të ardhshëm.*

Në përgjigje sa më sipër, Bashkia Shkodër me shkresën⁷ nr. 23191 prot., datë 10.11.2025, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Në kuadër të Planit të Veprimit të hartuar nga Bashkia Shkodër, për 8 familjet ankuese të sistemuara në vendqëndrimin Tepe, pas kalasë, për periudhën e parashikuar, kemi realizuar vlerësimin e thelluar social - ekonomik për secilën nga familjet, përfshirë gjendjen e banimit, të ardhurat, shëndetin dhe arsimin e fëmijëve.*

U realizuan fushata informuese dhe ndërgjegjësuere, nga ana e specialistëve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, si dhe fushata në bashkëpunim me grupe ndërsektoriale me përfaqësues të Shërbimit Social, Gjendjes Civile, Zyrës së Ndihmës Juridike Ligjore Falas.

Fushatat kishin për qëllim ofrimin e informacionit të qartë dhe praktik mbi procedurat e regjistrimit civil, mbështetje juridike, mbështetjen me ndihmë ekonomike dhe ushqimore, informim mbi aplikimin për të përfutur nga programet e strehimit social pas përfundimit të regjistrimit në gjendjen civile

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 660/8 prot., datë 20.08.2025.

⁷ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1585 prot., datë 12.11.2025.

dhe dokumentacionin e nevojshëm, përfshirjen në arsimin e detyrueshëm të fëmijëve, shërbimet shëndetësore dhe psiksociale, integrimin në programe punësimi dhe formime profesionale.

Bashkia Shkodër dhe partnerët e saj, do të vijojnë monitorimin dhe mbështetjen e këtyre familjeve me qëllim forcimin e integritetit social dhe përmirësimin gradual të cilësisë së jetesës së tyre.”

Bazuar në nenin 33, pika 11, të LMD, raportimi brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit, nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, nuk është një detyrim, i cili përbushet formalisht duke i kthyer një përgjigje Komisionerit brenda këtij afati, në vijim të vendimit të nxjerrë prej tij. Neni 33, pika 11, të LMD, vendos detyrimin ndaj subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa për të zbatuar vendimin e Komisionerit.

Referuar masave që janë urdhëruar nga Komisioneri në vendimin e tij nr. 161, datë 07.07.2025, si dhe në bazë të informacionit të administruar, rezulton se, Bashkia Shkodër nuk ka realizuar masën e parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të vendimit, pasi nuk rezulton që të ketë ndërmarrë asnjë masë lidhur me strehimin e përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, për familjet e shpërngulura të pakicës romë nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “*“Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”*”. Sa më lart, Komisioneri vlerëson se Bashkia Shkodër nuk ka zbatuar masat e parashikuara nga pika 2 dhe 3, të vendimit Nr. 161, datë 07.07.2025.

Në këto kushte, Bashkia Shkodër, nuk ka zbatuar të gjitha masat e përcaktuara në vendimin Nr. 161, datë 07.07.2025 dhe në këtë mënyrë nuk ka përmbyllur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmbyllje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 13, të ligjit të sipërpërmendur shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Bashkia Shkodër, ky nen përcakton shkrehimisht: “*Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë*”:..... b) *personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....*”

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se, Bashkia Shkodër është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33, pika 13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku sanksionohet se: “*12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara*

punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe bazuar në, faktin që, shkelja e konstatuar cenon një numër të madh familjesh dhe personash; faktin që, grupi i personave të prekur nga sjellja diskriminuese i përket pakicës kombëtare rome, e cila konsiderohet një grup vulnerabël, faktin që, Bashkia Shkodër, edhe pse ka patur kohën e mjaftueshme për sigurimit të një strehimi të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, për familjet e shpërngulura të pakicës rome nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, si pasojë e zbatimit të projektit “*“Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës”*”, nuk ka marrë asnjë masë; Komisioneri, arrin në përfundimin se, Bashkia Shkodër, duhet të gjobitet me 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit Nr. 161, datë 07.07.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ç”, nenin 33, pika 11, 12 dhe 13, germa “d”, si dhe nenin 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Bashkia Shkodër, të gjobitet në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit Nr. 161, datë 07.07.2025 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoka të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.
3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit Nr. 161, datë 07.07.2025, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA